



AFTËSIMI FINANCIAR TE TË RINJTË SHQIPTARË

Abstrakt

Sot të rinjtë shqiptarë, gjithnjë e më tepër, kërkojnë të kenë një gjendje të mirë financiare dhe të kenë para të mjaftueshme për të plotësuar dëshirat e tyre por pak prej tyre dinë të menaxhojnë ashtu siç duhet financat e tyre personale. Ky boshllëk informacioni vjen nga një sërë faktorësh, ku me shumë gjasa kryeson niveli i edukimit financiar në shkolla. Prandaj studimi që kemi zgjedhur të kryejmë titullohet “Aftësimin financiar te të rinjtë shqiptarë”. Përmes këtij studimi duam të vendosim në fokus rëndësinë e aftësimit financiar te të rinjtë, si faktor i rëndësishëm që ndikon në ekonominë e familjes. Gjithashtu, përmes këtij studimi, duam të japim disa zgjidhje praktike dhe të thjeshta për përmirësimin e aftësive financiare te të rinjtë. Studimi mbështetet në pyetësorë, ku përfshihen grupmoshat e reja që pyeten për financat e tyre personale në përgjithësi. Përmes pyetësorit grumbullojmë bazën e përgjithshme të të dhënave, lidhur me botëkuptimin e të rinjve për aftësimin financiar. A besojnë ata se një aftësim financiar më i mirë ndikon te mirëqenia dhe pasuria e tyre? Nga analiza e pyetësorëve, në vija të përgjithshme, edukata financiare është në nivele të ulta. Faktori kryesor është programi arsimor i shkollave të mesme dhe 9-vjecare, i cili përfshin shumë pak literaturë nga fusha e financave. Gjithashtu, edhe kultura familjare ka ndikim, sepse fëmijët shpesh nuk përfshihen në vendimmarrje financiare. Duke marrë në konsideratë këta faktorë nga njëra anë, dhe rëndësinë e aftësimit financiar nga ana tjetër, mendojmë se kemi të bëjmë me pengesa të kapërcyeshme. Kapërcimi i tyre është sfida e të rinjve shqiptarë, dhe në këtë kuadër, ne si studentë të financës japim rekomandimet tona.

Kristjana Proko, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
Anisa Klefti, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
Arjana Shemilli, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
Brisilda Zeqaj, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë